

“Nga fjala tek veprimi - Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë”

Raporti i Projektit “#Gjeje! – Lehtësimi i transportit urban në Tiranë”

Sara Frroku, Julian Sopaj, Klea Dahari, Anisa Omeri dhe Kevin Topi

Tiranë, 30 Prill 2022

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Shkurtimeve.....	2
1. Hyrje.....	3
2. Paraqitja e Problemit.....	4
3. Shkaqet e Problemit.....	6
4. Propozimi.....	7
5. Rezultatet e pyetësorit.....	10
6. Referencat.....	16
7. Aneksi 1.....	17
8. Aneksi 2.....	23
9. Aneksi 3.....	25

Tabela e Shkurtimeve

Tabela e mëposhtme përshkruan kuptimin e shkurtimeve dhe akronimeve të përdorira gjatë raportit.

Shkurtime	Kuptimi	Faqe
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë	3
CCIS	Center for Comparative and International studies	3
ESN	Erasmus Student Netëork	3
Scidev	Science and Innovation for Development	3

Hyrje

Nisma ‘#Gjeje’ është ideuar nga grupi i Tiranës në bazë të projektit “Nga fjala tek veprimi - Aktivizim për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” në Tiranë, e mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe zbatuar nga Scidev, CCIS dhe ESN Albania. Nisma Gjeje vjen si nevojë e studenteve për tu orientuar në stacionet dhe linjat e urbane në kryeqytet.

Synimi i nismës ‘#Gjeje!’ është lehtësimi i gjetjes së informacionit rreth linjave urbane në qytetin e Tiranës për studentët, në mënyrë që të thjeshtësojë orientimin e tyre në gjetjen dhe përdorimin e transportit publik.

Gjatë këtyre muajve janë identifikuar shkaqet që kanë sjellë problemin e orientimit në linjat dhe stacionet e urbaneve, si mungesa e hartave orientuese nëpër stacione, mungesa e emërtimeve të stacioneve, mungesa e sistemit gjurmues (GPS), shpërndarje e gjerë dhe e jo e organizuar e informacionit në web, aplikacione jo-funksionale, ose lehtësisht të përdorshëm. Projekti synon të ofrojë një zgjidhjeve njëkohësisht sa inovative dhe ekologjike, si dhe pa shumë kosto.

Zgjidhja që projekti “#Gjeje!” propozon është ofrimi i hartave digjitale të stacioneve dhe linjave urbane nëpërmjet pikave orientuese të pajisur me QR code. Ne kemi arritur të evidentojmë hartat digjitale nga burime të besueshme, dhe më pas link-et e tyre janë konvertuar në QR Codes të cilat do të mund të përdoren nga të rinjtë për tu orientuar në linjat e urbaneve. Për të rritur vetëdijen rreth problematikës së orientimit në linjat urbane dhe zgjidhjes që projekti ofron, gjatë muajve të zbatimit kemi ndërmarrë nisma sensibilizuese në rrjete sociale dhe media tradicionale.

Paraqitja e problemit

Transporti publik në Tiranë paraqet shumë problematika dhe cilësohet prej banorëve si një problem madhor që ka kryeqyteti i Shqipërisë. Gjetjet e një studimi të realizuar nga Qendra Steps treguan se 82.4% e 1020 qytetarëve të anketuar raportojnë nivel të ulët të sigurisë gjatë udhëtimit në urban.

Performanca e shërbimit publik të transportit urban përmbush vetëm kushtet minimale në

pothuajse çdo aspekt, si nga ana e higjienës, si nga ana e mbipopullimit të tyre, si dhe nga jo-korrektësia në respektimin e orareve. Këtyre problemeve shumë të rëndësishme ju mbigjitet një problematikë tjetër që prek më shumë studentët se sa grupmoshat e tjera. Bëhet fjalë për mungesën e hartave dhe të informacionit përsa i përket linjave të transportit urban.

Sipas një studimi vullnetar rreth shërbimit të transportit publik, të kryer në 2018 nga Edmond Çera rreth dobësive dhe mundësive të transportit publik, informacioni i afishuar për përdoruesit e urbaneve është në nivel shumë të ulët. Vetëm 6% e stacioneve dhe 46% e autobusëve kanë të afishuar hartat e linjave. Fakti që hartat si informacion gjenden të afishuara brenda në autobus është gjë pozitive, por shpesh herë nuk janë në gjendje të mirë dhe janë të vendosura në vende të cilat kapen me vështirësi nga syri i qytetarit. Problemi tjetër është se këto harta nuk përditësohen shpesh kur ka ndryshime të stacioneve të këtyre linjave.

Autori i raportit, Edmond Çera deklaroi: “Këto harta duhet të përditësohen për aq kohë sa ka ndryshime të stacioneve të këtyre linjave. Për ilustrim, një rast ku vendndodhja e stacioneve ka ndryshuar dhe harta nuk është përditësuar është në linjën “Kombinat-Kinostudio”. Ashtu si në rastin informacionit në stacion, as në autobus nuk ka rastisur informacion i afishuar lidhur me oraret e autobusit, tarifat e shërbimit apo abonentë”.




Figura 1. Informacioni i afishuar në stacion dhe brenda autobusit

Grafiku i realizuar nga Porta Vendore

Në Tiranë gjenden shumica e studenteve të Shqipërisë, rreth 82 000 studentë. Shumë prej tyre të ardhur nga rrethet dhe zhvendosur për herë të parë në kryeqytet. Te gjithë studentet që nuk kanë jetuar më parë në Tiranë e kanë tepër të vështirë të orientohen me linjat e urbaneve. Shpesh herë studentët në Tiranë detyrohen të ecin rrugë të gjata më këmbë për shkak se nuk kanë informacionin e nevojshëm se ku gjenden stacionet e urbaneve dhe çfarë rrugësh përshkojnë këto urbane. Mungesa e këtij informacioni shkakton konfuzion të madh tek studentet dhe të huajt.

Kjo është një kosto psikologjike për studentin pasi e lodh fizikisht dhe e streson mendërisht. Mbi të gjitha është dhe kosto në kohë. Mungesa e informacionit mbi linjat e urbaneve u shkakton njerëzve vonesa në punë, në shkollë, dhe në shumë raste të tjera ku korrektësia me oraret është e nevojshme. Kjo dobësi e transportit tonë urban ka shumë hapësire për përmirësim.

Shkaqet e problemit

Shkaqet themelore

- Mungesa e hartave të vendosura nëpër stacione dhe mungesa e emërtimeve të stacioneve.

Në të gjitha vendet e botës, stacionet e urbaneve kanë harta të cilat ndihmojnë në mënyrë të jashtëzakonshme studentet e rinj të orientohen. Përveç kësaj studentet e huaj apo çdo person tjetër mund të aksesojë lehtësisht hartat e trajektoreve të urbaneve në internet, në faqe si sbahn.berlin, që ofron qartësisht hartën e stacioneve dhe linjave urbane në qytetin e Berlinit. Pra, këtij problemi mund ti gjendet lehtësisht një zgjidhje.

- Informacioni ekzistues në WEB është i paorganizuar

Ekziston një faqe e tillë e Bashkisë Tiranë, Open Data në Tirana.al që përmban informacione mbi vendodhjen e stacioneve të urbaneve dhe cilat linja urbanesh kalojnë në to. Përveç informacionit tekstual kjo faqe përmban dhe harta të trajektoreve të urbaneve. Pra studenti shih dhe vizualisht rrugët që përshkojnë këto urbane.

Me anë të celularit, me një klikim në këto faqe, studenti mund të orientohej shumë lehtë. I vetmi problem është se informacioni në këtë faqe, edhe pse ekzistent nuk është aq i organizuar sa në faqen për linjat e Berlinit. Pavarësisht kësaj, webfaqe të tilla janë një ndihmese e madhe për studentet e Tiranës.

Shkaqe të tjera sipërfaqësore

- Mungesa e njohurive digjitale dhe orientimin në Web

Fatkeqësisht në vendin tonë, qytetarët e marrim si të mirëqenë faktin që informacione të tilla për linjat urbane janë të pamundura të aksesohen. Ndoshta kjo vjen ngaqë qytetarët shqiptarë janë të fundit në rajon për njohuritë dixhitale sipas të dhënave të Eurostat. Ne jemi një vend me njohuri të dobëta në këtë fushë dhe nga kjo vjen dhe mungesa e informacionit që kanë studentët për faqe të tilla udhëzuese në internet. Ata duhet të informohen dhe drejtohen.

- Aplikacione jofunksionale

Aplikacione të tilla si ‘Tirana ime’ përpiqen të ofrojnë një zgjidhje për këtë problem. Ky aplikacion pavarësisht se përmban hartat e të gjitha linjave të urbaneve në Tiranë nuk është i përditësuar pasi trajektorja e linjave dhe stacionet ndryshojnë shpesh.

Shkaqe të pashmangshme

- Mungesa e sistemit gjurmues GPS

Në vende të tjera të botës, urbanët kanë sistem GPS me anë të të cilave mund të gjurmohen në kohë reale. Kjo fatkeqësisht nuk përdoret nga shumica e linjave urbane në vendin tonë.

Propozimi

Në fazën e parë të shkrimit të projektit kemi arritur të evidentojmë qëllimin strategjik dhe objektivat e projektit. Fokusi ynë ka qenë tek lehtësimi i gjetjes së informacionit rreth linjave urbane në qytetin e Tiranës për studentët.

Objektivat tona specifike janë:

1. Përmbledhja dhe organizimi i informacionit në një vend të vetëm.
2. Ndërgjegjësimi i shoqërisë rreth nevojës për informacion të plotë dhe lehtësisht të aksesueshëm.

Gjatë fazës së parë të shkrimit të projekt-idesë realizuam disa takime fizike dhe online mentoruese me bashkëthemeluesen Lutjona Lula ku u bë dhe njohja me grupin e punës. Gjatë bashkëbisedimeve mes ne të pestëve u lind ideja për të realizuar këtë projekt, ku dhe më pas analizuam problemin që shqetëson kryesisht studentët dhe ndamë detyrat mes anëtareve të grupit. Gjatë kësaj faze ne realizuam dhe pyetësin në lidhje me problemin e orientimit me linjat urbane.

Ky pyetësor na shërbente për të kuptuar se cilat ishin linjat më të përdorura nga të rinjtë në grup moshat 18 deri në 25 vjeç që i përket dhe një grup moshe ku shumica janë studentë.

Fazën e parë e mbyllëm me organizimin e një forumi publik ku ishin të pranishme Bora Muzhaqi, Ministre për Rininë dhe Fëmijët, znj. Enxhi Lipa, Tirana European Youth Capital 2022 dhe znj. Greta Kokalari, Shoqata për Integrimin e Zonave Informale SHIZI – AIIA, në moderimin e Lutjona Lula, bashkëthemeluese e ESN Tirana. Në forum kishte dhe aktorë të tjerë dhe organizata kombëtare dhe rajonale. Në forumin që u zhvillua ditën e hënë datë 21 Mars 2022, ne aktivistët e ESN Tirana, Klea Dahari, Julian Sopaj, Kevin Topi, Anisa Omeri dhe Sara Frroku prezantuan nismën tonë që i vihet në ndihmë transportit publik-urban në Tiranë.

Në fazën e dytë të projekt-zbatimit, që u realizua në muajt prill-maj u bë shpërndarja e pyetësorit në rrjete sociale i cili mori rreth 540 përgjigje. Më pas ne analizuam përgjigjet nga ky pyetësor dhe nxorëm pesë linjat më të frekuentuara:

1. Ish Kombinat- Institut
2. Porcelan - Qendër
3. Tirana e Re
4. Unaza
5. Kombinat - Kinostudio

Pasi zbuluam se cilat ishin linjat e përdorura, ne përdorëm të dhënat për hartat të gjetura në OpenData Tirana, të publikuara nga Drejtoria e Statistikave pranë Bashkisë së Tiranës.

Linkun e hartave e kemi kaluar nëpërmjet një programi (Bitly) i cili lejon te gjurmohet se sa here është përdorur QR pra numri i herëve qe është skanuar. Me pas për gjenerimin dhe dizenjimin e QR codeve kemi përdorur programin Canvas.

Ka dy lloj QR, statike dhe dinamike.

Ky lloj kodi është statik, domethënë se nëse ndodh një ndryshim ne linkun e gjeneruar atëherë dhe QR codi nuk të çon në faqen e kërkuar.

Ndërsa dinamiku lejon qe i njëjti QR i gjeneruar të çoj në faqen e kërkuar edhe nëse kësaj faqeje i ndryshon linku. Ne kemi përdorur një QR statik, pasi është i vetmi lloj që Canva mundet të gjenerojë.

Kjo përmban risk për projektin, por duke qene se OpenData është një faqe e sigurve, dhe ne besojmë ne vazhdueshmërinë e saj, probabiliteti qe këto linke te ndryshojnë është tepër i ulet.

Me 22 prill u zhvillua një takim online me të gjithë grupet e interesit duke përfshirë studentë dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë. Në këtë takim u ri prezantuan dhe njëherë objektivat dhe qëllimin e projektit, analizën e problemit dhe shkaqet që e shkaktojnë atë. Më pas ne si aktivistë prezantuam dy produktet e këtij projekti, pyetësin në lidhje me transportin urban dhe krijimin e pesë QR codeve. Gjatë kësaj faze u zhvilluan dhe dalje televizive dhe fushata ndërgjegjëse në media sociale.

Shumë të rëndësishëm në këtë projekt janë dhe aktorët e përfshirë nga të cilët kemi grumbulluar informacionet e nevojshme, studentët të cilët kanë ngritur problematikën e tyre që i shqetëson prej vitesh , drejtuesit e linjave urbane , instituti për kontrollin e cilësisë së transportit urban dhe organizatat studentore.

Ndonëse përfituesit kryesor do të jenë studentët vendas, gjithashtu ky projekt do të vijë në ndihmë, studentëve të huaj dhe turistëve të cilët do të vizitojnë Tiranën edhe më shumë tani që është kryeqyteti i rinisë.

Rezultatet e pyetësorit

Cila është mosha juaj?


Results

Options	%	Count
18 - 21 vjeç	45.26	258
22 - 25 vjeç	33.33	190
26 - 30 vjeç	14.74	84
31 - 35 vjeç	6.67	38

Cila është mosha juaj?

PIE CHART

- 18 - 21 vjeç - 258
- 22 - 25 vjeç - 190
- 26 - 30 vjeç - 84
- 31 - 35 vjeç - 38



A jeni përdorues i rregullt i transportit publik?


Results

Options	%	Count
Po	77.19	440
Jo	22.81	130

A jeni përdorues i rregullt i transportit publik?

PIE CHART

- Po - 440
- Jo - 130




Cilat prej linjave përdorni më shumë ? (mund të zgjidhni më shumë se një linjë urbane)

Results

Options	%	Count
Selitë-Kris tal-Kodra e Die...	3.49	37
TEG - Stacioni i Trenit	8.03	85
Institut - Tiranë	10.29	109
Tirana e Re	19.83	210
Kashar - Yzberisht - Qe...	2.46	26
Materniteti i Ri - Ish fusha e...	0.85	9
Unaza e Re	9.54	101
Kombinat - Qendër - Kin...	11.43	121
Sauk - Qendër - Stacioni i Trenit	3.87	41
Qytet Studenti - Qendër - Jorda...	5.67	60
Porcelan - Qendër - Porce...	6.70	71
Sharrë - Uzina Dinamo - 5 Maji	1.61	17
Tufinë - Qendër - Tufinë	2.17	23
Laprakë - Qendër - Lapra...	1.98	21
Ish Uzina e Autotraktorit - ...	3.02	32
City Park - Qendër	0.66	7
Vorë - City Park - Megatek - Qe...	3.97	42
others	4.44	47
No Answer	-	10

Cilat prej linjave përdorni
më shumë ? (mund të
zgjidhni më shumë se
një linjë urbane)


BAR CHART



Sa të lehtë e keni patur
për tu orientuar me
stacionet e urbanit ?

PIE CHART

- Shumë të lehtë - 80
- Të lehtë - 175
- Pothuajse të lehtë - 175
- Të vështirë - 110
- Shumë të vështirë - 30



Sa të lehtë e keni patur për
tu orientuar me stacionet e
urbanit ?

Results

Options	%	Count
Shumë të lehtë	14.04	80
Të lehtë	30.70	175
Pothuajse të lehtë	30.70	175
Të vështirë	19.30	110
Shumë të vështirë	5.26	30

Sa të lehtë e keni patur
për tu orientuar me
stacionet e urbanit ?

BAR CHART




A mendoni se harta e linjave urbane është e nevojshme për tu orientuar nëpër stacione?

Results

Options	%	Count
Është tepër e nevojshme	63.51	362
Është e nevojshme	30.00	171
Është e panevojshme p...	4.56	26
Është e panevojshme	1.93	11

A mendoni se harta e linjave urbane është e nevojshme për tu orientuar nëpër stacione?


BAR CHART



A mendoni se harta e linjave urbane është e nevojshme për tu orientuar nëpër stacione?

PIE CHART


- Është tepër e nevojshme - 362
- Është e nevojshme - 171
- Është e panevojshme por do is...
- Është e panevojshme - 11



A jeni në dijeni për aplikacionet apo faqeve të web të cilat ofrojnë informacione rreth linjave?


PIE CHART

- Po - 89
- Jo - 262
- Nuk kam dëgjuar fare - 219



A jeni në dijeni për aplikacionet apo faqeve të web të cilat ofrojnë informacione rreth linjave?

BAR CHART



A jeni në dijeni për aplikacionet apo faqeve të web të cilat ofrojnë informacione rreth linjave?

Results

Options	%	Count
Po	15.61	89
Jo	45.96	262
Nuk kam dëgjuar fare	38.42	219

Referencat

- <https://shqiptarja.com/lajm/problemet-e-transportit-publik-ne-tirane-qytetaret-vonesa-ne-stacione-kushte-te-keqija-e-faturino-arrogante>
- <https://www.levizalbania.al/sq/lajme/urbanet-stresojne-tiranen-90-te-pakenaqur-frike-nga-covid-grabitjet-e-ngacmimet-seksuale>
- <https://www.facebook.com/pages/category/Nonprofit-organization/Qendra-STEPS-360428001131855/>
- <https://portavendore.al/ep-content/uploads/2018/11/Studim-p%C3%ABr-transporti-publik-n%C3%AB-Tiran%C3%AB-prill-maj-2018.pdf>
- <https://portavendore.al/>
- <https://www.monitor.al/bie-me-5-numri-i-studenteve-ne-2021-universitetet-ge-humben-studente-dhe-ato-ge-fituan/>
- <https://sbahn.berlin/en/route-map/>
- <https://a2news.com/2021/08/19/njohurite-ne-teknologji-eurostat-shqiptaret-te-fundit-ne-rajon-dhe-europe-per-vitin-2019/>

Aneks 1

QR Codes të zhvilluar



1.1 Informacion i përgjithshëm mbi linjat e transportit urban

Linja 5 Ish Kombinati i Autotraktorëve, Institut



1.2 Informacion mbi Linjën 5 – Ish Kombinati i Autotraktorëve, Insitut

Linja 11 Porcelan-Qendër



1.3 Informacion mbi Linjën 11- Porcelan – Qendër

Linja 13 Tirana e Re



1.4 Informacion mbi Linjën 13 – Tirana e Re

Linja 14 Unaza



1.5 Informacion mbi Linjën 14 – Unaza e Re

Linja 15 Kombinat-Kinostudio



1.6 Informacion mbi Linjën 15 – Kombinat, Kinostudio

Aneks 2

Pyetsori

1. Cila është mosha juaj :

- A. 18 – 21
- B. 22 – 25
- C. 26 – 30
- D. 31 – 35

2. A jeni përdorues i rregullt i transportit urban?

- A. Po
- B. Jo

3. Cilat prej linjave përdorni më shpesh? (mund të zgjidhni më tepër se një linjë)

- A. Selitë - Kristal- Qendër - Allias
- B. TEG - Stacioni I Trenit
- C. Kashar
- D. City Park - Qendër
- E. Kombinat - Institut
- F. Materniteti I Ri - ish Fusha e Avioacionit - Qendër
- G. Tirane e Re
- H. Unazë
- I. Laprakë
- J. Tufinë
- K. St. I Trenit - Sauk - TEG
- L. Qyteti Studenti - Jordan Misja
- M. Porcelani
- N. Sharrë - uzinë "Dinamo" - 5 Maji
- O. Kombinat - Kinostudio

4. Sa te lehte e keni patur për tu orientuar me stacionet e urbanit?

- A. Shumë të lehtë
- B. Të Lehtë
- C. Pothuajse të lehtë
- D. Të veshtirë
- E. Shumë të veshtirë

5. A mendoni se harta e linjave urbaneve është e nevojshme për tu orientuar nëpër stacione?

- A. Tepër e nevojshme
- B. E nevojshme
- C. E panevojshme, por do të ishte një plus për tu orientur
- D. E panevojshme

6. A Jeni ne dijeni te aplikacioneve apo faqeve web te cilat ofrojnë informacione rreth linjave?


- A. Po
- B. JO
- C. Nuk kam dëgjuar fare

7. I keni përdorur ndonjëher ato? Nëse nuk i keni përdorur atëherë përse?

- A. Po
- B. Jo

Aneks 3

Foto nga forumi, nga daljet mediatike dhe nga takimet e zhvilluara mes grupit të punës



3.1 Takim brain-storming i zhvilluar në Zoom.



3.2 Takim fizik i grupit të punës




3.3 Forumi i parë publik i zhvilluar më 21 Mars, 2022



3.4 Kronikë në Top Channel mbi ndërgjegjësimin e nismës



3.5 Prezantimi i nismës në emisionin Ditë e Re



3.6 Forumi online i mbajtur më datë 22 Mars, 2022



3.7 Prezantimi i nismës në Radio Tirana